




REPUBLIKA E KOSOVËS	KOMUNA E VUSHTRRISË - GJESTINA VUÇITRNI
01 Nr / Dr	152117
Nr. i fq. / Br. st	- 15 -
Data / Datum	25. 5. 2017
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

### PROCESVERBAL

#### NGA MBLEDHJA E -IV- (E KATËRT) E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 27 PRILL 2017

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:07.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Gentiana Rama, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muhammed Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakic.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, nënkyetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – e përshëndeti vendimin e gjykatës franceze për lirimin e gjeneralit dhe ish-kryeministrit Ramush Haradinaj nga arresti dhe paraqiti disa pikë shtesë përfutje në shqyrtim në rendin e ditës.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – pyeti zyrën ligjore se mbledhja e sotme ai i plotëson kushtet ligjore që mbahet sa i përket afatit të thirrjes së saj, sepse në referim të nenit 43 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale të gjitha materialet e kuvendit dërgohen shtatë ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Kjo duhet të dihet me qëllim që mos të marrim vendime të kundërligjshme.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – tha se ky afat është problem që të zbatohet pasi është shumë i gjatë, por çështja e dërgimit të materialit varet nga ekzekutivi komunal se sa në kohë i përgatit këto materiale. Andaj nëse ka ankesa në këtë drejtim çdo anëtar i kuvendit mund t'i adresohet MAPL-së përfundimisht e vendimeve të aprovuara në kundërshtim me ligjin.

**Melihate Basholli, anëtar e kuvendit** – propozoi dy pikë shtesë përfutje në rend të ditës dhe atë, kërkesë përofrim të ndihmës financiare përblerjen e një joleku ortopedik për Amra Brahimin, kurse pikë tjetër është që të formohet një komision përvlerësimin e dëmeve bujqësore dhe në pemëtarit, të shkaktuar nga të ftoshtit.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – pyeti se cila është arsyja që nuk është sjellë në kuvend Informata përgjendjen sociale në komunën tonë, kur dihet se kjo temë ka qenë e paraparë me Planin e Punës së Kuvendit. Andaj në këtë rast kërkoi që kjo temë të trajtohet në mbledhjen e ardhshme të kuvendit.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – kërkoi arsyen përsë është hequr nga rendi i ditës, propozim-vendimi përcaktimin e lokacionit përdërtimin e lapidarit përdëshmorët e UÇK-së, pasi që kjo pikë është shqyrtuar në KPF. Lidhur me këtë çështje është mbajtur një diskutim publik me veteranët e atyre lokalitetave, dhe ideja ka qenë që kuvendit mos t'i merret kompetenca, por që ai si organi më i lartë të marrë vendim përkëtë çështje. Mandaj ai shtoi se

kuvendi duhet të vendos për caktimin e këtij lokacioni duke i marrë për bazë tri propozimet e bëra, dhe bëri të ditur se për të gjitha temat janë njoftuar organet komunale dhe tani nuk kupton se përsë neglizhohet kjo çështje duke u hequr nga rendi i ditës. Në fund tha se kjo pikë duhet të futet në rend të ditës për shqyrtim që mos të shkaktohen vonesa.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** – njoftoi se nuk e kishte nënshkruar propozim-vendimin për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit për dëshmorët e UÇK-së, me arsyen se duhet të gjendet një kompromis me përfaqësuesit e atyre lokaliteteve. Tutje shtoi se situata lidhur me këtë temë nuk është e mirë dhe nëse kuvendi vendos pa u gjendur një marrëveshje ka drojën se do të shkaktohen acarime tjera dhe pakënaqësi të banorëve të atyre lokaliteteve. Mandej ceku se nuk e di se sa është ligjore që qytetarët të adresojnë kërkesa për ndihmë financiare në kuvend, kur dihet fakti se planifikimi i buxhetit është bërë dhe mjetet për secilën kategori janë ndarë, andaj njoftoi se çdo kërkesë që vjen në organet komunale do ta shqyrtojë dhe nëse ka mjete dhe hapësirë ligjore do t'i realizojë ato kërkesa. Në fund tha se është mirë që të formohet një komision komunal për vlerësimin e dëmeve në pemë nga të ftohit. Dhe përsëriti se është shumë vështirë të respektohet afati prej shtatë ditësh për dërgimin e materialeve të kuvendit.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – njoftoi për takimin që kanë pasur në kalanë e qytetit ku kishte marrë pjesë edhe komandanti i Batalionit të I-rë i Brigadës 142 të UÇK-së, është diskutuar dhe pajtimi ka qenë që ky lapidar të vendoset afër urës së fshatit Prelluzhë. Për këtë çështje e kanë dhënë mendimin e vet kryesit e organizatave të dala nga lufta.

*Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 22 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi këtë:*

#### REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit e datës 10.03.2017;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 30.03.2017;
3. Shqyrtimi i informatës për objektin e Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”;
4. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet buxhetore për muajt: Janar, shkurt, mars 2017;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat në fshatin Kollë;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore;
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr. 85/17 për shpallje të ankandit publik;
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e vendimit Nr.46/17 për subvencionimin e shoqatës “Drita jonë”;
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për subvencione dhe transfere;
12. Të ndryshme.
  - a). Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin e Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Organeve të Tij;
  - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve financiare të komunës;
  - c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e rrugës së re “HELGE ONSRUD” në Vushtrri;
  - d). Shqyrtimi i planit të veprimit për punësimin e personave me nevoja të veçanta;

**dh).** Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit të UÇK-së.

1.Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit e datës 10.03.2017;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 21 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi procesverbalin e mbledhjes së jashtëzakonshme të KK-së të datës 10.03.2017.*

2.Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 30.03.2017;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 28 vota “për” të tjerat “abstenim ” aprovoi procesverbalin e mbledhjes e rregullt e KK-së të datës 30.03.2017..*

3.Shqyrtimi i informatës për objektin e Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”;

**Shpresa Rama, drejtoreshë e DKRS-së – paraqiti një ekspozë të shkurtër lidhur me objektin e ri të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”, i cili është planifikuar të ndërtohet.**

**Egzon Bajraktari, hartues i projektit të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”-** paraqiti sqarime profesionale lidhur projektin për ndërtimin e objektit të ri të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – pyeti se në bodrumin e objektit ekzistues të kësaj qendre i cili është në një sipërfaqe bukur të madhe, tani në të ardhmen objekti a do të ketë dalje emergjente.

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit** – pyeti se në tërë objektin e kësaj qendre, a do të ketë qasje të lehtë për personat me nevoja të veçanta e sidomos për personat me shikim të dobësuar. Mandej pyeti sesi do të jetë pika informuese, a do të jetë ndonjë tabelë në hartë ku do të kenë qasje më të lehtë të gjithë qytetarët dhe vizitorët e qendrës së kulturës. Pastaj ceku se nuk është e kënaqur me vandin e sallës së leximit dhe mendon se nuk është mirë që kjo sallë të jetë një kat më lartë se biblioteka, si dhe pyeti se a ka mundësi që të rritet numri i ulëseve në sallën e kësaj qendre.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – e përgëzoi hartuesin, për projektin që e ka hartuar, ku projektin e vlerësoi si shumë të mirë dhe apeloi që njerëzit e rinj të çmohen si pasuri dhe të përdoren në kuptimin më pozitiv për kontributin që mund ta jasin për komunën.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – pasi e falënderoi profesorin Egzon Bajraktari për hartimin vullnetar të këtij projekti, vlerësoi se kërkесë e grupit kuvendar të LDK-së ka qenë që mos të rrënohet objekti i qendrës së kulturës, dhe aty të ndërtohen pallate ndërtimore. Si dhe pyeti se ku qëndron hapësira e ansamblit “Hasan Prishtina”.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** – tha se pamja e jashtme e objektit nuk është duke i pëlqyer, pasi që qyteti i Vushtrrisë është i vjetër dhe kur i shikojmë këto ngjyrat e fasadave, kemi përshtypjen se Vushtrria është një qyteti i ri i cili është duke u ndërtuar.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se sot ka ardhur një projekt shumë më i komplektuar se sa në të kaluarën, dhe ajo çka është edhe më e rëndësishme është fakti se shtëpisë së kulturës është duke iu rritur sipërfaqja, e që në projektin e kaluar nuk ka qenë kështu. Ndërsa sa i përket fasadës, vlerësoi se kjo fasadë është ajo ekzistuesja kështu që nuk e humb identitetin e vet përveç që i shtohen disa elemente që e modernizojnë këtë objekt. Në fund pyeti se çfarë do të ndodh me vendimin që është marrë për rrënimin e pjesshëm të objektit, kur dihet se tanë kemi vetëm ndryshim dhe shtim të një kati të këtij objekti dhe ceku se është mirë që edhe përkundër

vlerësimëve të mëhershme se objekti ekzistues është i paqëndrueshëm ai tanë po del se ka qenë shumë i qëndrueshëm.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – pasi falënderoi profesorin, vlerësoi se dy çështje janë fondamentale ruajtja e trashëgimisë dhe funksionaliteti i këtij objekti. Tështo se brenda kësaj strukture të këtij objekti, a do të ketë mundësi që të rritet numri i ulëseve të sallës për shikues, kur kihet parasysh fakti se në të ardhmen shihet mundësia e rritjes së popullatës. Në fund tha se në të kaluarën ka pasur ide se çfarë duhet të bëhet me objektin e qendrës së kulturës, por nuk është marrë vendim për rrënimin e atij objekti. Andaj ceku se nuk është mirë të spekulohet se dikush në të kaluarën paska dashur ta rrënojë këtë objekt.

**Habibe Gérxhaliu, anëtare e kuvendit** – pyeti se në këtë objekt a do të ketë hapësirë për karrocat e personave me nevoja të veçanta dhe aparate të dëgjimit për personat me të meta në dëgjim.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – e falënderoi profesorin për hartimin e këtij projekti dhe për mënyrën e prezantimit para anëtarëve të kuvendit.

**Egzon Bajraktari, hartues i projektit të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”-paraqiti** sqarime lidhur me projektin, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** – pasi falënderoi profesorin për punën e bërë, vlerësoi se është mirë dhe e gjëzon fakti që kur bëhet fjalë për çështje kapitale po merret mendimi i ekspertëve tanë dhe po e shohim se kjo ka dhënë rezultate pozitive në rastin e ndërtimit të objektit të kësaj qendre. Gjithashtu ceku se gjithherë duhet t'u jepet mundësia dhe hapësira ekspertëve të mirëfilltë që të kemi produktivitet për projektet të cilat i bëjmë në komunën tonë.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – pyeti se sa do të jetë kostoja e ndërtimit të këtij objekti, dhe a do të mund komuna financiarisht ta përballojë këtë projekt.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** – tha se në emër të Komunës së Vushtrrisë e falënderon profesorin Egzon Bajraktari për punën e kryer, si dhe për gatishmërinë që të hartoje edhe projektin detaj të kësaj qendre. Tështo se personalisht është angazhuar shumë që ky projekt të dalë mirë, dhe se tanë është hera e parë që jemi me një projekt konkret se si do të duket qendra e kulturës, përfaktin se në të kaluarën kemi pasur biseda dhe ide, por jo iniciativa për zhvillimin e këtij projekti. Pastaj njoftoi se komuna jonë ka një marrëveshje me MKRS-në për ndërtimin e këtij objekti, ku në kuadër të kësaj marrëveshjeje kjo e fundit ka siguruar 250 mijë euro për këtë vit për ndërtimin e këtij objekti, kurse komuna ka të planifikuara 200 mijë euro për këtë vit, përvitin e ardhshëm komuna ka të planifikuara 490 mijë euro, ndërsa në një nen të marrëveshjes ministria e ka pranuar që të planifikojë mjete shtesë të nevojshme për ndërtimin dyvjeçar të kësaj qendre. Çështja e kostos financiare të këtij objekti do të specifikohet me projektin detaj i cili do të bëhet më vonë. Mandej njoftoi se komuna ka një kontratë me një kompani për hartimin e projekteve dhe në baza ligjore nuk kemi drejt të marrim një kompani tjetër për hartimin e projekteve. Lidhur me qëndrueshmërinë e objektit ekzistues ceku se kemi raportin nga një kompani e licencuar e cila ka bërë vlerësimë profesionale ku është konstatuar se objekti ekzistues mund të rinovohet, por edhe statika e tij mund të përforcohet, por kjo normalisht se ka kosto të lartë financiare. Hartimi i këtij projekti është bërë falas nga profesori Bajraktari, por nëse ky i fundit i bashkëngjitet kompanisë që merret me hartimin e projekteve, përhartimin e projektit detaj, atëherë kompania në fjalë duhet ta paguajë profesorin Egzon Bajraktari. Në fund ai e falënderoi në emër të të gjithë qytetarëve të komunës profesorin Egzon Bajraktari për punën e bërë.

**Nexhat Mervoci, zyrtar i Drejtorisë së Urbanizmit** - paraqiti sqarime profesionale lidhur me statikën dhe qëndrueshmërinë e objektit ekzistues të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”, si dhe dha sqarime lidhur me objektin e ri të kësaj qendre, i cili do të ndërtohet.

4.Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet buxhetore përmuajt: Janar, shkurt, mars 2017;

**Muharrem Shabani**, anëtar i kuvendit – tha se në material të kuvendit, kjo pikë e rendit të ditës emërtohet si raport tremujor, kurse në rend të ditës shkruan informatë, andaj me këtë pyeti se kuvendi a ka obligim ligjor që t'i aprovojë apo jo këto raporte. Të shto se kemi ngecje në realizimin e të hyrave vetanake ku për këtë periudhë kemi vetëm 13,3 % dhe për këtë ne nuk i dimë arsyet. Në kategorinë e tatimit në pronë kemi shumë të painkasuara në afro 2,179.320 €, e që imponon nevojën e një mobilizimi apo të hartimit të një plani të veprimit nga administrata komunale. Mandej realizimi i shpenzimeve është në masën prej 56 %, kurse për disa lloj shpenzimesh, të cilat janë rritur duhet të shikohet dhe të analizohen se përsë janë rritur këto shpenzime.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale;

**Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së** - paraqiti sqarime hyrëse profesionale lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, para anëtarëve të kuvendit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim Komuna e Vushtrrisë bën këmbimin e pronës së paluajtshme, pjesë nga parcela kadastrale P-70202062-00763-0, në sipërfaqe që do të caktohet pas vlerësimit nga organi kompetent, nga sipërfaqja e përgjithshme prej  $10981\text{ m}^2$ , zona kadastrale Qytezë, pronë e Komunës së Vushtrrisë, me pjesën e parcelës kadastrale P-70202062-00288-0, në sipërfaqe prej  $127\text{ m}^2$ , nga sipërfaqja e përgjithshme prej  $1780\text{ m}^2$  zona kadastrale Qytezë, pronë e Daut (Murat) Berishës nga Smrekonica.

2. Këmbimi i pronave, të cekura në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të sigurimit të hapësirës për rregullimin e trotuarit në rrugën e fshatit Smrekonicë.

3. Obligohet Kryetari i komunës që në afat prej pesë (5) ditësh, pas aprovimit të këtij vendimi nga Kuvendi i komunës të bëjë kërkesë në Ministrinë e Financave-ZVPP-së për vlerësimin e pronave të paluajtshme, të cilat janë objekt i këmbimit, si dhe të lidhë kontratë për këmbimin e pronave me pronarin e cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë parcializimin e ngastrave kadastrale në sipërfaqen e cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Kollë;

**Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së** - tha se këtë propozim-vendim e ka hartuar Drejtoria për Shërbime Publike, dhe nga vizita në vend të ngjarjes shihet se gjendja faktike e kësaj parcele është varreza, por tani nevojitet vendimi i kuvendit dhe parcializimi i asaj prone me qëllim që të dihen saktë kufijtë e parcelës dhe sipërfaqja e cila do të shfrytëzohet për varreza.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** - propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet përmbledhjen e radhës, me qëllim që drejtoria kompetente t'i bëjë matjet dhe parcializimin e asaj prone dhe mandej të dimë saktë se për cilën pronë po merr vendim kuvendi.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi që këtë pikë të rendit të ditës ta shtyjë për ndonjëren nga mbledhjet e radhës së kuvendit.

#### 7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë;

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – pyeti se përse gjatë këtyre ditëve të fundit ka filluar degradimi i tokës bujqësore përgjatë rrugës magjistrale, ku ka ndotje me materiale ndërtimore, si dhe është evidente se gjatë ditëve të vikendit qytetarët bëjnë ndërtime, pa marrë leje nga organet përkatëse. Pastaj vlerësoi se për një çështje me kaq peshë, të shkruhet vetëm gjysmë faqe informatë është paksa joserioze dhe propozoi që kjo informatë duhet të jetë pak më e detajuar edhe me të dhëna lidhur me zbatimin e aktvendimeve të marra nga Drejtoria e Inspektiveve.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – përsëriti se çka është duke ndodhur me tokat që gjenden nën sistemin e ujitjes, ku janë duke u ndërtuar ndërtime të “egra” në rrugën magjistrale Vushtrri-Prishtinë. Madje pyeti lidhur me vendosjen e tarracave në rrugën “Tirana” nga ana e disa lokaleve.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** – tha se kjo informatë duhet të specifikohet duke u paraqitur në mënyrë tabelore me qëllim që të kemi një pasqyrë më të qartë ku do të dihen lokacioni, pronari, problemi dhe specifikat tjera të këtyre çështjeve.

**Bujar Pllana, zyrtar i Drejtorisë së Inspektiveve** – paraqiti sqarime lidhur me informatën duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** – tha se zyrtarët e Drejtorisë së Inspektiveve i kanë të gjitha kushtet që t'i kryejnë detyrat e tyre sipas ligjit. Ku ekziston kompania për rrënimin e ndërtimeve pa leje, por edhe rregullativen ligjore në bazë të cilave duhet të veprojnë. Sa i përket ndërtimeve buzë magjistrales, në bazë të planit urban, në rreze prej 150 m gjatësi mund të ndërtohet konform kritereve të parapara.

#### 8. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore;

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** – pyeti se në komunën tonë a kemi grupe apo komisione të trajnuara dhe të specializuara për kontroll të ushqimit, sa herë në vit kontrollohen marketet tona dhe vendet tjera si në qytet ashtu edhe në zonat rurale. Mandej sa janë të sigurta në përdorim artikujt ushqimore, prejardhja e burimit dhe vendi i originës së atyre ushqimeve. Pastaj a është ngritur ndonjë kallzim penal për keqpërdorimin e të gjitha hallkave lidhur me transportimin dhe shitjen e mallrave ushqimore.

**Syzana Syla, anëtare e kuvendit** – tha se kjo informatë është e mangët, ku nga tabela shihet se janë realizuar 78 inspektime, ndërsa nuk janë specifikuar se sa inspektime janë bërë tek lokalet ushqimore siç janë: marketet, hoteleritë, kafiteritë, çajtoret, mishtoret, bukëpjekësit. Mandej nuk ceket sa inspektime janë bërë për librezat sanitare, ku në bizneset e lartcekura do të mund të punonin punëtorë me ndonjë sëmundje ngjitetëse, për këtë çështje ligji parashev se duhet të bëhen analiza në çdo gjashtëmuaj. Konsumatorët kanë vërejtje se mishshitësit dhe bukëpjekësit nuk përdorin dorëza gjatë shërbimit të tyre, kurse tek marketet konsumatorët kanë hasur në bukë me afat të skaduar e sidomos tek buka integrale dhe ajo e thekrës ku afati i përdorimit është i shkurtër. Mandej qebaptoret duhet të vendosin letra higjienike për pastrimin e duarve e jo peshqir. Për lokalet të cilat gjenden afër shkollave dhe spitalit, inspektorati duhet të ketë kontroll më të shpeshtë, lidhur me mallrat e skaduara, pastërtinë dhe cilësinë e mallrave. Eksposimi i mallrave jashtë lokaleve të mos lejohet nga inspektorati. Duhet të ndërmerrin masa ndaj bizneseve që punojnë pas orës 24:00, si dhe nëse kemi mungesë të inspektorëve atëherë duhet të rritet numri i tyre.

9.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr. 85/17 për shpallje të ankandit publik;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet pika 1 e vendimit Nr.01-85/17 e datës 30.03.2017, ku shtohet teksti si në vijim: Lejohet shpallja e ankandit publik për shitjen e materialit ndërtimor të pjesës së objektit të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”.

2.Autorizohet Kryetari i komunës që të themelojë komisionin për shpërndarjen (falas) të materialit ndërtimor pas rrënimit të objektit të komunës dhe pjesës së objektit të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”, në rast se dështon ankandi publik në mungesë të ofertave.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Administratë.

10.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e vendimit Nr.46/17 për subvencionimin e shoqatës “Drita jonë”;

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** - tha se në mbledhjen e kaluar kishte ndodhur një gabim kur i ishin shkurtuar subvencionet shoqatës “Drita jonë”, dhe përsëriti se edhe në mbledhjen e kaluar kishte kërkuar që ndaj klubeve sportive të zbriten nga 50 respektivisht 100 euro dhe kështu të rritet shuma e subvacioneve për shoqatën e të verbërve “Drita jonë”.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** – tha se mjetet për subvencione janë të limituara, kurse kërkesat janë gjithherë shumë të mëdha. Pastaj njoftoi se sa i përket vizitës nga ana e shkollës së mesme gjimnazi në Kroaci, ceku se shpenzimet për këtë vizitë janë mbuluar nga ana e qeverisë, dhe për këtë çështje propozoi që të formohet një komision që të verifikohet se sa shpenzime ju nevojiten këtyre përfaqësuesve të shkollës së gjimnazit gjatë kësaj vizite.

**Përfaqësuesja e shoqatës “Drita jonë”**- para anëtarëve të kuvendit lexoi një kërkesë të anëtarëve të kësaj shoqate duke kërkuar që mjetet për këtë shoqatë të rriten.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se e përkrah propozimin e kryesuesit të kuvendit, që të hiqen nga 100 euro nga kubet sportive që kanë përfituar mjetet mbi vlerën 1500 euro, kurse nga kubet që iu janë ndarë mjete nën vlerën prej 1500 euro të hiqen nga 50 euro dhe kështu shuma e mjeteve për shoqatën “Drita jonë”, të jetë 1550 euro.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** – tha se kishte me qenë mirë që këto gjëra të parashihen në fazën kur planifikohet buxheti. Kurse në emër të grüpuit kuvendar e përkrahi propozimin përritjen e subvacioneve për shoqatën “Drita jonë”.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** – në emër të grüpuit kuvendar të LDK-së e përkrahi propozimin përritjen e subvacioneve për shoqatën “Drita jonë”.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – tha se këto gjëra duhet të parashihen me kohë dhe mos të na ndodh që disa subjekteve t’iu cungohen mjetet financiare, dhe shtoi se e përkrah propozimin që t’i rriten mjetet shoqatës “Drita jonë”.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim Shoqatës të të Verbërve “Drita jonë”, i ndahen mjete financiare në vlerë prej një mijë e pesëqind e pesëdhjetë euro (1550 €), të cilat do të shfrytëzohen për financimin e nevojave dhe aktiviteteve të kësaj shoqate.

**2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi, sigurohen nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, pozicioni “klubet dhe shoqatat sportive”, ashtu që nga secili klub sportiv që ka përfituar mjete financiare mbi një mijë e pesëqind euro (1500 €), zbritet vlera prej njëqind euro (100 €), kure nga klubet sportive që kanë përfituar mjete nën vlerën prej një mijë e pesëqind (1500 €), zbritet vlera prej pesëdhjetë euro (50 €). Mjetet financiare të siguruara nga pozicioni i sipërcekur i dedikohen Shoqatës të të Verbërvë “Drita jonë”.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpérndarjen e mjeteve nga fondi për subvencione dhe transfere;

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – tha se e kemi të ditur faktin se kjo shumë e mjeteve e dedikuara për klubet sportive, është mjaft e vogël për arsyen se një shumë e konsiderueshme është ndarë për klubin e futbollit. Sa i përket klubeve të hendbollit të femrave dhe meshkujve nuk është dashur të ketë dallime sepse përafërsisht këto klube janë të ranguara njëjtë në listë. Mandjej klub i basketbollit “Vushtrria” dhe KB “Vushtrria Basket” është e njëjta ekip, porse njëra ekip është për të rinj, kurse tjetra për “seniorët”. Pastaj klubit të basketbollit “Vushtrria F” i janë ndarë 1700 €, kurse është veç një ligë që i bie që është vetëm liga e parë dhe nuk ka superligë dhe në këtë rast nuk është e drejtë që këtij klubit t’i ndahet kjo shumë. Mandjej klub i “gjimnazistë” nuk është duke zhvilluar gara gjatë stinës së pranverës. Andaj propozoi që tri klubeve të hendbollit t’u barazohen mjetet financiare. Pastaj dy klubeve të basketbollit t’u merren nga 50 € dhe këto mjete t’i qiten klubit të volejboollit femrat.

**Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit** – propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet, për faktin se për shpenzimet e vitit të kaluar, klubet sportive nuk i kanë sjellë raportet financiare.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** – tha se mjetet për një mbledhje të jashtëzakonshme do të ishte mirë të dedikohen për shoqatën “Drita jonë”.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se në ardhmen është mirë të bëhet një komision i cili do të merej me hartimin e propozimit për ndarjen e subvencioneve, dhe kuvendi vetëm ta votonte atë propozim. Mandjej ai bëri vërejtje për atë se që në fillim të hartimit të kësaj liste, kjo po shkon tek subjektet përfituese (klubet) dhe tanë po dezinformohet, manipulohet dhe po dalin probleme tjera lidhur me subvencionet.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – tha se është mirë që është bërë përmirësimi i emrave të klubeve sportive, dhe përsëriti se ato emërtimet e mëhershme janë bërë me qëllim të kamuflimit të mjeteve të përfituar. Tutje apeloi që në klubet sportive në strukturat e tyre drejtuese, të mos futen njerëz nga sfera e politikës (partive politike), sepse në këtë formë vetëm sa po i humb vlera sportit.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** - tha se në kryesinë e klubit, nuk ka hyrë si politikan, por ka hyrë për ta ndihmuar, sikur e ka ndihmuar edhe në të kaluarën ai dhe familja e tij.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – kërkoi nga Drejtoria e Kulturës, që të jap sqarime lidhur me klubet sportive siç thuhet inekzistente, me qëllim që të kemi një pasqyrë të qartë para se të votojmë këtë çështje.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – tha se e ka ndihmuar sportin vushtrriais ai dhe familja e tij, jo nga prizmi i politikanit, por me qëllim të avancimit të sportit të komunës sonë, dhe do të vazhdojë edhe me tutje ta ndihmojë.

**Shpresa Rama, drejtoreshë e DKRS-së** – paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin për ndarjen e subvencioneve, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – tha pas ndërkombëtarizimit të sportit, nuk mundet që klubet lokale të mbajnë emrin Kosova sepse në këtë formë nuk mundet asnjë klub të regjistrohet në federatën përkatëse me emrin Kosova.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** - në rekapitullimin e debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, lexoi një nga një klubet sportive dhe shumat financiare që do t'i përfitojnë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 14 vota “për” 9 vota “kundër” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, mjetet buxhetore të komunës - fondi për transfere dhe subvencione për vitin 2017, në shumën prej 23,450.00 € (për klube dhe shoqata sportive) ndahen si më poshtë:

1.1 KH. Vushtrria-F (KH Kosova-F).....	2.400.00 €
1.2 KH. Vushtrria -M ( ish-KH Kosova-M).....	2.800.00 €
1.3 KH. “Samadrexha-F” .....	2.400.00 €
1.4. KH. “Samadrexha-M” .....	1.700.00 €
1.5 KBB. Vushtrria-M (ish-KBB Kosova-M).....	1.450.00 €
1.6 KBB. Vushtrria-F (ish-KBB Kosova-F).....	1.600.00 €
1.7 KBB “Vushtrria Basket” .....	950.00 €
1.8 KV. As “Vushtrria”.....	1.050.00 €
1.9 KV. “Gjimnazisti”.....	650.00 €
1.10 KV. Vushtrria -F (ish-KV Kosova F).....	1.150.00 €
1.11 K. Kickboxit “Kosova”.....	950.00 €
1.12 KB. “Kosova”.....	550.00 €
1.13 KB. “Vushtrria”.....	550.00 €
1.14 KM. “Kosova”.....	450.00 €
1.15 Muhamet Rama.....	150.00 €
1.16 K. i gjimnastikës “Kosova”.....	250.00 €
1.17 KSH. “Llamkos” .....	750.00 €
1.18 KSH. “Shqiponja” .....	450.00 €
1.19 KPP. “Hasan Prishtina”.....	750.00 €

1.20 KPP. "Vushtrria".	750.00 €
1.21 KF. "Radnik-1".	250.00 €
1.22 KF. "El Clasico".	250.00 €
1.23 KXH. "Studenti".	350.00 €
1.24 K. i atletikës "Kosova".	350.00 €
1.25 SHP. "Silnica".	250.00 €
1.26 SHPKF SSH.	250.00 €
<b>Gjithsej.....</b>	<b>23,450.00 €</b>

2. Për klubet sportive, të cilat bartin emrin "KOSOVA" dhe nuk e kanë ndryshuar emrin sipas Udhëzimit Administrativ Nr.3/2015, neni 1, pika 2, lëshuar nga MKRS-Departamenti i Sportit më datë 16.03.2015, nuk do të lidhet marrëveshje deri në zbatimin e këtij udhëzimi administrativ.

3. Mjetet në shumën e cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të shpërndahen në bazë të kritereve dhe kushteve të përektuara me Rregulloren për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndihmë Momentale Entiteteve Publike dhe Jopublike 01Nr.37-2/11, dt.24.02.2011, si dhe pas dorëzimit të raportit nga përfituesit e këtij fondi për shfrytëzimin e mjeteve nga viti 2016.

4. Me këtë vendim ndryshohet pika 3.6 e vendimit numër Nr.46/17 e datës 23.02.2017, lidhur me aprovimin e listës së subvencioneve, pozicioni "klubet dhe shoqatat sportive" ku nga vlera e përgjithshme prej 25,000.00 € janë zbritur 1,550 € dhe për këtë kategori shuma e mbetur është në vlerë prej 23,450.00 €.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

12.Të ndryshme.

a).Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin e Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Organeve të Tij;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë "unanime" vendosi me sa vijon:

1.Jepet në diskutim publik Rregullorja për Punën e Kuvendit dhe Organeve të Tij Nr.01-71/13 04.04.2013.

2.Diskutimi publik fillon nga data 03 maj 2017 dhe zgjat deri më 24 maj 2017.

3.Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ

për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

**4.Obligohet Kryesuesi i Kuvendit që si propozues i ndryshimit të rregullores në fjalë të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu obligohet “Komisioni Kuvendar për Ndryshimin e Rregullores së Punës së Kuvendit, që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin maj 2017.**

**b).Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve financiare të komunës;**

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit –propozoi që mjetet të cilat po rialokohen, një pjesë e tyre të shfrytëzohet për ndërtimin e një ure në fshatin Stanoc i Poshtëm.**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim rialokohen mjetet brenda kategorisë së kapitaleve në kuadër të programit të njëjtë (kategorisë së njëjtë) nga një nënkategori në tjetrën nënkategori të shpenzimeve.**

**2. Rialokimet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi janë të paraqitura në tabelën në vijim:**

Emri i projektit	Kodi funksional	Kodi i projektit	Fondi 10	Fondi 21	Nga nënkategori	Në nënkategori
Rrënimi i objektit të komunës dhe rregullimi i oborrit	0451	45117	30,000.00	10,000.00	31120	32120
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	0451	41408	5,000.00	10,000.00	31610	31230
Ndërtimi i serrave	0421	43903	25,000.00	5,000.00	32050	33200
Pemëtari (mjedra, qershi, lajthi, ftua etj.)	0421	45221	30,000.00	20,000.00	32055	33200
Përkrahje bizneseve të reja dhe ekzistuese me pajisje	0421	45267	35,000.00	5,000.00	32055	33200
Shpronësimi i tokave	0610	90237	11,855.40	81,163.00	31230	32100
Hartimi i projekteve	0620	43910	50,000.00	21,200.00	31690	31230
Inventar për shtëpinë e komunitetit	1060	45296	5,000.00		31110	31620
Pajisje për zërim	0820	45312	8,000.00	2,000.00	31123	31690
Teknologji informative	0133	43889		10,000.00	31690	31610

**2.1 Projekti në programin Infrastruktura Publike (18184) me kod funksional 0451, rrënimi i objektit të komunës dhe rregullimi i oborrit, të rialokohen mjetet nga**

nënkategorië ndërtesat administrative afariste (31120) në nënkategoriënë parqet nationale (32120).

2.2 Projekti në programin infrastruktura publike (18184) me kod funksional 0451, sinjalizimi horizontal dhe vertikal, të rialokohen mjetet nga nënkategorië pajisje të teknologjisë informative (31610) në nënkategoriënë ndërtimi i rrugëve lokale (31230).

2.3 Projekti në programin bujqësi (47024) me kod funksional 0421, ndërtimi i serrave, të rialokohen mjetet nga nënkategorië bashkëfinancim me IPA (32050) në nënkategoriënë transfere kapitale për entitete jopublike (33200).

2.4 Projekti në programin bujqësi (47024) me kod funksional 0421, pemëtari (mjedra, qershi, lajthi, ftua etj.), të rialokohen mjetet nga nënkategorië implementimi reformues (32055) në nënkategoriënë transfere kapitale (33200).

2.5 Projekti në programin bujqësi (47024) me kod funksional 0421, përkrahje bizneseve të reja dhe ekzistuese me pajisje, të rialokohen mjetet nga nënkategorië implementimi reformues (32055) në nënkategoriënë transfere kapitale (33200).

2.6 Projekti në programin shërbimet kadastrale (65120) me kod funksional 0610, shpronësimi i tokave, të rialokohen mjetet nga nënkategorië ndërtimi i rrugëve lokale (31230) në nënkategoriënë toka (32100).

2.7 Projekti në programin planifikimi urban dhe inspektimet (66425) me kod funksional 0620 hartimi i projekteve, të rialokohen mjetet nga nënkategorië pajisje tjera (31690) në nënkategoriënë ndërtimi i rrugëve lokale (31230).

2.8 Projekti në programin shërbimet rezidenciale (75617) me kod funksional 1060, inventar për shtëpinë e komunitetit, të rialokohen mjetet nga nënkategorië ndërtesa të banimit (31110) në nënkategoriënë mobilie (31620).

2.9 Projekti në programin shërbimet kulturore (85024) me kod funksional 0820, pajisje për zërim, të rialokohen mjetet nga nënkategorië objekte kulturore (31123) në nënkategoriënë pajisje tjera (31690).

2.10 Projekti në programin administrata (16324) me kod funksional 0133, teknologji informative, të rialokohen mjetet nga nënkategorië pajisje tjera (31690) në nënkategoriënë pajisje të teknologjisë informative (31610).

**3. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi Nr.80/17 i datë 30.03.2017 i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e rrugës së re “HELGE ONSRUD” në Vushtrri;

**Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së** - paraqiti sqarime hyrëse sa i përket parcelës në të cilën do ndodhet kjo rrugë, e cila do të emërohet me emrin “HELGE ONSRUD” në Vushtrri.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** – propozoi që të bëhet emërtimi i ndonjë rruge me emrin e nënës së Sherif Tërrstenes, Hatiqe Morina, e cila ka vuajtur nëpër burgjet dhe kazamatat serbe.

**Ilirjana Azemi, zyrtare në Drejtorinë e Urbanizmit** - paraqiti sqarime lidhur me emërtimin e rrugës së re në Vushtrri me emrin “**HELGE ONSRUD**”.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – pyeti lidhur me atë se një pjesë e kësaj rruge është në pronësi private, andaj kjo çështje a është rregulluar apo jo, me qëllim që më vonë mos të shfaqen probleme lidhur me pronësinë sa i përket kësaj rruge dhe emërtimit të saj.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se duhet të definohet çështja e pronësisë së kësaj rruge para se kjo të votohet për emërtim, por edhe për shtrimin në asfalt.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet emërtimi i rrugës së re me emrin **HELGE ONSRUD**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është skica e rrugës e cila paraqet vendin se ku gjendet rruga dhe e cila do të emërtohet me emrin si në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

ç).Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien e pronës së komunës në shfrytëzim afatgjatë;

**Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së** - dha sqarime para anëtarëve të kuvendit, duke arsyetur se në këtë pronë që po jepet në shfrytëzim do të ndërtohet një objekt administrativ, për nevojat e kompanisë së ujësjellësit dhe ky propozim-vendim është në harmoni me ligjin.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se duhet të sqarohet se a kemi të drejt t'i japim në shfrytëzim afatgjatë në këtë kohë dhe pa kompensim dhe për këtë duhet të konsultohet edhe zyrtari ligjor. Pastaj ai përsëriti shqetësimin e tij lidhur me fenomenin e lëshimit të shtetësisë sonë nga qytetarët tanë, ku në të gjitha ato shtete që nuk e lejon dy shtetësinë qytetarët tanë janë duke e denoncuar shtetësinë kosovare, dhe po e marrin shtetësinë e atij shteti që ka një obligim të tillë ligjor, të moslejimit të dyshtetësisë. Në vazhdim ai njoftoi kuvendin se nga organet e administratës është informuar se numri i personave që kanë lëshuar shtetësinë në komunën tonë është 2155 persona dhe kjo çështje është alarmuese dhe tepër shqetësuese për institucionet lokale, por edhe për ato qendrore.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** – pyeti se ky objekt administrativ a i dedikohet vetëm kompanisë së ujësjellësit apo edhe Kompanisë “Uniteti” për faktin se këto dy kompani ndodhen në një çati.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se pasi ka ide që këto ndërmarrje si ajo e ujësjellësit dhe ajo për menaxhimin e mbeturinave do të pavarësohen, atëherë ky objekt që po ndërtohet në pronësi të kujt do të mbetet në rast se këto kompani bëhen komunale.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** – tha se është shumë keq që materialet e kuvendit po vinë kështu shpejt e shpejt dhe anëtarët e kuvendit nuk e dinë se çfarë po votojnë shpeshherë. Andaj lidhur me këtë të shikohet dhe të merret mendimi i zyrës ligjore se a kemi të drejtë apo jo që këtë pronë ta japim në shfrytëzim.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

**1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjetë e pestë (45) vite e pronës se paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, e cila gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-4865/1, Zona Kadastrale Vushtrri dhe e cila përfshin një sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup> të marrë nga sipërfaqja e përgjithshme 8890m<sup>2</sup>.**

**2. Ngastra kadastrale e cekur në pikën 1 të këtij vendimi paraprak jepet në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjetë e pestë (45) vite Kompanisë Rajonale Ujësjellësi Mitrovicë – Njësia Operative Vushtrri, për ndërtimin e objektit administrativ në sipërfaqe prej 500m<sup>2</sup> pa kompensim.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.**

**4. Pjesë e këtij vendimi janë: certifikata për të drejtön e pronësisë, kopja e planit, kërkesa e parashtruar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.**

**d). Shqyrtimi i planit të veprimit për punësimin e personave me nevoja të veçanta;**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi Planin e Veprimit për Punësimin e Personave me Nevoja të Veçanta;**

**dh). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit të UÇK-së;**

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - propozoi Isa Hajrizin për anëtar të komisionit.  
Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit – propozoi Agim Bregajn për anëtar të komisionit.  
Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – propozoi Ali Januzi për anëtar të komisionit.**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim formohet komisioni komunal, i cili do të merret me shqyrtimin e propozimeve për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorët e UÇK-së, të Batalionit – I- (parë), të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës, në këtë përbërje:**

**1.1 Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit (PDK);**

**1.2 Agim Bregaj, anëtar i kuvendit (LDK);**

**1.3 Ali Januzi, anëtar i kuvendit (VV);**

**2. Komisoni në fjalë ka për obligim që të zhvillojë negociata (bisedime) me përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta dhe me përfaqësuesit e fshatrave se ku do të vendoset ai lapidar.**

**3. Pas përfundimit të këtij procesi komisioni ka për obligim që të hartojë procesverbal lidhur me arritjen e një marrëveshjeje për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit dhe të njëjtin duhet t’ia adresojë Kuvendit të komunës.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.**

e). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

**Bahrije Pllana, anëtar e kuvendit** – propozoi që në mbledhjen e ardhshme të kuvendit, të ftohet një përfaqësues i KEDS-it që të referojë para anëtarëve të kuvendit lidhur me furnizimin me energji elektrike.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – paraqiti një procesverbal, nga një takim i tri fshatrave Sfaraçak i Ulët, Mavriq, dhe Nadakoc, ku është ngritur problemi i betonjerkës i Kompanisë “Arjani” e cila po shkakton mjaft shumë problem në zhurmë dhe ndotje të ambientit në këto fshatra. Në vazhdim ai e lexoi këtë procesverbal para anëtarëve të kuvendit.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** – tha se ditëve të fundit ka pasur djegie të pyjeve në rajonin e shalës nga faktori njeri, dhe për këtë pyeti organet komunale se a janë ndërmarrë masa lidhur me këtë problematikë. Pastaj shtroi nevojën që në rrugën e fshatit Pasomë të hiqen mbeturinat që janë gjuajtur bri kësaj rruge dhe të cilat po shkaktojnë ndotje mjedisore dhe pengesa për banorët e këtij fshati.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** – pyeti se a është kompetencë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike emërtimi i fshatrave, për faktin se në shumë vendbanime nuk kemi shenja që tregojnë emërtimet e tyre, dhe shpesh njerëzit nuk e dinë se në çfarë vendbanimi ndodhen. Më tutje ai e mori si referencë rrugën Vushtrri-Skënderaj, ku në fshatrat përgjatë të cilave kalon kjo rrugë nuk kemi shenjë të komunikacionit që lajmëron vendbanimet. Andaj i propozoi Drejtorisë së Shërbimeve Publike që në këto vendbanime të vendosen këto shenja të komunikacionit.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – pyeti Drejtorinë e Inspektiveve sa a ka vendim dhe nëse po kush e ka marrë atë vendim për rrënimin e objektit (rrënim i pullazit dhe mureve mbajtëse) të ish-ndërmarrjes Kosova-Trans - stacioni i autobusëve. Mandej shtroi çështjen e dy flamujve që janë vendos tek semaforët e qytetit, rruga e fshatit Studime, të cilët janë shumë të dëmtuar, për të cilët kërkoi që të hiqen nga aty ose të njëjtit të ndërrohen me të rinj.


**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – pasi e përgëzoi DSHP-në, për punën që ka bërë në heqjen e deponive ilegale të mbeturinave, kërkoi që një e tillë të hiqet e cila ndodhet në fshatin Prelluzhë nga ura e deri tek stacioni i policisë, si dhe pyeti se kur do të bëhet renovimi i rrugëve, të cilat janë prerë dhe të njëjta që nga viti i kaluar kanë mbetur të papërfunduara.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – pyeti Drejtorinë e Arsimit dhe Zyrën Ligjore se a është ligjore që drejtori i Drejtorisë së Arsimit të aplikojë për vendin e punës zyrtar për shkolla të mesme të larta, pasi një gjë e tillë është jomorale dhe skandaloze.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që parcela e cila ndodhet tek stadiumi i gomës të pastrohet nga mbeturinat (zhavorri i mbetur të hiqet nga ajo pronë).


**Mbledhja përfundoi në orën 15:00.**

**Bastri Duraku**



**Procesmbajtës**

**Shpëtim Zhegrova**

  
**Kryesues i Kuvendit**